

Maj 2025

Buletini

Rritja e Biomasës dhe Sekuestrimi i Karbonit në Kosovë

Pyjet janë një nga mjetet më të fuqishme në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Si absorbues natyror të karbonit, pyjet kanë fuqinë qoftë për të emetuar ose sekuestruar dioksidin e karbonit (CO₂), varësisht nga mënyra se si menaxhohen. Aftësia e tyre për të ruajtur karbonin dhe për të zvogëluar varësinë nga lëndët djegëse fosile i bën ato të jenë esenciale në përpjekjet për të ulur emetimet e gazrave serrë në të gjithë botën.

Në Kosovë, CNVP ka punuar në mënyrë aktive që nga viti 2015 për të shfrytëzuar këtë potencial përmes projektit *Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Mjedisin dhe Zhvillimin Ekonomik (SUNREED)*, i financuar nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë (Sida).

Projekti përqendrohet në pyjet cungishte të degraduara, ku CNVP ka krijuar 175 zona testimi të përhershme në 15 komuna. Këto zona, po ashtu të njohura si Sipërfaqe të Përhershme Provë (SPP), shërbejnë për të monitoruar rritjen e biomasës dhe sekuestrimin e karbonit. Qëllimi është të vlerësohet kapaciteti i këtyre pyjeve për të thithur dioksidin e karbonit dhe ofruar të dhëna të besueshme për formësimin e politikave mjedisore dhe për të kontribuar në ekuilibrin global të karbonit.

Deri më tani, Sipërfaqe të Përhershme Provë janë ngritur në 15 nga 38 komunat e Kosovës, të cilat mbulojnë 19 zona kadastrale. Këto lokacione janë të vendosura strategjikisht në pyjet cungishte të degraduara dhe përfaqësojnë një gamë të larmishme të llojeve të pronësisë:

- **43%** janë pyje shtetërore të angazhuara në menaxhimin e përbashkët të pyjeve;
- **16%** bien nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP);
- **32%** janë në pronësi private;
- **8%** janë në pronësi private, por nën menaxhim të përbashkët të komunitetit;
- **1%** janë në konteste pronësore ose ligjore.

Çdo lokacion monitorohet në baza vjetore nëpërmjet inspektimeve vizuale dhe çdo tre vjet duke përdorur matje të detajuara (duke mos e përfshirë peshën për shkak të kufizimeve në terren).




Rezultatet kryesore (2015 – 2024):

Gjatë periudhës nëntë vjeçare, ndikimi i përpjekjeve dhe progresit të CNVP Kosova është përmbledhur si më poshtë:

- **175** Sipërfaqe të Përhershme Provë (SPP) të krijuara në 15 komuna
- **19,273.27 hektarë** të sipërfaqes së përgjithshme mbuluar me SPP-të
 - **11,541.6 hektarë** të tokës pyjore
- **Stoku i biomasës (m³/ha):**
 - Mesatarja fillestare: **87,987 m³/ha**
 - Mesatarja e vitit 2024: **120,310 m³/ha**
- **Stoku i karbonit (t/ha):**
 - Mesatarja fillestare: **26.369 t/ha**
 - Mesatarja e vitit 2024: **36.075 t/ha**
- **Oksigjeni i liruar (t/ha):**
 - Mesatarja fillestare: **86.410 t/ha**
 - Mesatarja e vitit 2024: **132.395 t/ha**

Këto shifra tregojnë një trend të qartë: pyjet e Kosovës, madje edhe ato në gjendje të degraduar, kanë potencial të konsiderueshëm për të thithur karbonin dhe për të kontribuar në mënyrë domethënëse në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Përmes monitorimit dhe menaxhimit të kujdesshëm, projekti SUNREED po hedh bazën për zhvillimin afatgjatë ekonomik dhe veprimin klimatik në Kosovë.



Lokacionet e Sipërfaqeve të Përhershme Provë të ngritura në Kosovë

Një Qendër e Re e Biomassës Sjell Zhvillim në Viti

Një moment historik është arritur në Viti me krijimin e qendrës së parë të mbledhjes së biomassës në rajon. Me shumë sesa thjesht një objekt, ajo shihet si një nxitës ndryshimi për pronarët e pyjeve private (PPP), ekonominë lokale dhe mjedisin.

Qendra e grumbullimit krijon një treg lokal shumë të nevojshëm për biomassën. Me një kapacitet grumbullimi deri në 2,000 m³ në vit, qendra ndihmon në shndërrimin e asaj që dikur konsiderohej mbetje pyjore në një produkt të vlefshëm – në veçanti për prodhimin e ashklave të drurit dhe lëndës djegëse me efikasitet energjetik. Prandaj, përtej fitimeve ekonomike, qendra sjell përfitime mjedisore, të tilla si zvogëlimi i mbetjeve pyjore në pyje dhe eliminimi i rrezeve të zjarreve në pyje.

Qendra është krijuar nëpërmjet një partneriteti në mes të CNVP Kosova dhe kompanisë Dardani, një kompani e njohur pyjore në pronësi të Hajdin Leskovicës.

Me përvojë në infrastrukturën pyjore, tregtinë e drurit dhe pyllëzimin, kompania Dardani menaxhon 150 hektarë pyje private dhe ka punësuar tetë punëtorë me orar të plotë.

Çdo vit, kompania përpunon 7,000–8,000 m³ dru, me rreth 2,000 m³ biomassë që zakonisht lihet në pyll – tani e shfrytëzueshme falë objektit të ri.



Aktivitetet e rrallimit të pyjeve bazuar në Planen e Menaxhimit të Pyjeve.

Partneriteti me CNVP jo vetëm që ka ndihmuar në hapjen e qendrës së biomassës, por gjithashtu e ka inkurajuar kompaninë Dardani të shkojë përtej planeve të saj fillestare, duke investuar në më shumë infrastrukturë si, pajisje për peshim dhe objekte të deponimit.

Këto përmirësime i sjellin dobi si kompanisë ashtu edhe partnerëve të saj, në veçanti pesë Pronarëve të Pyjeve Private (PPP) që tani punojnë drejtpërdrejtë me kompaninë Dardani përmes marrëveshjeve formale të bashkëpunimit. Së bashku, ata kanë zhvilluar Planen e Menaxhimit të Pyjeve (PMP) për 900 hektarë në të gjithë Kaçanikun dhe Shtimen, duke u përqendruar në prerjen e qëndrueshme dhe krijimin e mundësive për të shitur biomassën që më parë nuk ishte e tregtueshme.

Qendra e mbledhjes së biomassës në Viti po ndërton një të ardhme më të qëndrueshme për komunitetet lokale dhe po mbështet një menaxhim më të mirë të pyjeve në të gjithë Kosovën.

Iniciativa është pjesë e projektit Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore për Mjedisin dhe Zhvillimin Ekonomik (SUNREED), i mbështetur nga Ambasada e Suedisë në Prishtinë (Sida) dhe i zbatuar nga CNVP Kosova.



Foto sipër: Mbledhja e biomassës para ngritjes së qendrës. Foto poshtë: Qendra e re e mbledhjes së biomassës e ngritur në Viti, duke krijuar më shumë mundësi për pyje të qëndrueshme dhe energji të pastër.



Fuqizimi i Grave Rurale përmes Rrjetëzimit

Gratë janë shtyllë kryesore e çdo shoqërie - duke i çuar përpara familjet, komunitetet dhe ekonominë. Në mes tyre, gratë rurale luajnë një rol të madh, duke kultivuar tokën, duke rritur familjet dhe duke kontribuar në ekonominë lokale.

Si pjesë e përpjekjeve të saj të vazhdueshme për të promovuar barazinë gjinore dhe zhvillimin gjithëpërfshirës rural, CNVP Kosova ka mbështetur krijimin e Rrjetit të Grave Sipërmarrëse Rurale - një iniciativë e hartuar për të forcuar zërat e grave rurale dhe për të mbështetur fuqizimin e tyre ekonomik dhe social.

Ky rrjet në rritje shërben si një platformë e unifikuar për gratë rurale për t'u lidhur, për të avokuar dhe udhëhequr ndryshimet brenda komuniteteve të tyre.

Kjo iniciativë filloi me formimin e pesë grupeve kryesore rajonale - në Pejë, Prizren, Gjiilan, Prishtinë dhe Ferizaj - duke bashkuar gratë që janë tashmë aktive në komunitetet e tyre përmes shoqatave të pronarëve të pyjeve dhe aktiviteteve bujqësore. Këto grupe kryesore formuan bazën e rrjetit kombëtar, i cili u krijua për të inkurajuar bashkëpunimin dhe për të rritur rolet e grave në udhëheqje dhe vendimarrje.



Duke punuar së bashku në përgjdhjen e përfaqësuesve të rrjetit.

Me mbështetjen e partnerëve kryesorë, përfshirë Agjencinë për Barazi Gjinore, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Mjedisit dhe komunat lokale,

CNVP Kosova ka mbështetur trajnime dhe punëtori në nivel kombëtar që nga viti 2022.

Këto sesione u përqendruan në të drejtat e grave, vendimarrjen, pronësinë e tokës dhe pronës, udhëheqjen organizative dhe fuqizimin ekonomik - në veçanti në sektorët e Produkteve Pyjore Jo-Drusore (PPJD) dhe Bimëve Mjekësore dhe Aromatike (BMA).



Ndarja e praktikave të mira nga vendet e BE-së në krijimin e rrjetit për gratë rurale. Krijimi i rrjetit është iniciuar këtu.

Duke theksuar rëndësinë e krijimit të rrjetit, Sebiha Ahmeti Ramaxhiku, Këshilltare e Lartë për Mjedis në CNVP Kosova dhe një nga kontribueset e para të iniciativës, tha:

“Rrjeti është një platformë e vlefshme që u lejon grave të mësojnë nga përvojat e njëra-tjetrës - diçka që më parë ka munguar. Ndërkohë që këto gra vazhdojnë të ecin përpara, pritjet që ato të marrin role edhe më aktive në sektor dhe në rajon.”

Me vështrim nga e ardhmja, CNVP Kosova do të mbetet e përkushtuar në forcimin e kësaj platforme, duke siguruar që gratë rurale jo vetëm të jenë të përfshira, por edhe - të udhëheqin drejt - formësimin e së ardhmes dhe komuniteteve të tyre. Partneritetet e qëndrueshme me palët e interesit të qeverisë dhe sektorit privat do të ndihmojnë gjithashtu në krijimin e një rrjeti më të qëndrueshëm.

Për më shumë informacion mbi punën e CNVP Kosova dhe ndikimin e saj, vizitoni

<http://www.cnvp-eu.org/enq/index.php>

